

VENDIM
Nr.211, datë 11.3.2020

PËR ANGAZHIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR TË SIGURUAR ZBATIMIN E MASAVE PARANDALUESE NDAJ EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të neneve 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/1, të nenit 21, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të siguruar zbatimin e masave parandaluese ndaj epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
 2. Detyrat operacionale dhe niveli i angazhimit do të përcaktohen me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe do të koordinohen me Policinë e Shtetit.
 3. Drejtimi operacional i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të kryhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 4. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama